



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Mekanizmi i konsultimeve me OShC dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të Organeve të Stabilizim-Asociimit (OSA) BE - Kosovë: Kalendar i takimeve konsultuese të raundit III

Ky kalendar zbaton [Udhëzuesin për konsultime me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të OSA BE - Kosovë](#), sipas [Rregullores së Qeverisë nr. 13/2016 për Funkcionimin dhe Përfaqësimin e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Strukturat e Stabilizim-Asociimit](#). Takimet konsultuese për secilin OSA (Komitetin, nënkomitetet dhe grupet e veçanta) do të mbahen në Prishtinë, dhe në to do të ftohen për të marrë pjesë [entitetet e regjistruara](#) për këtë mekanizëm përmes [shpalljes publike](#).

Pasi që përgatitja e dokumentacionit punues për secilin takim konsultues varet nga Komisioni Evropian, ky kalendar parasheh datat e planifikuara të mbledhjeve konsultuese (si data tentative, brenda javëve të specifikuara). Datat e sakta të secilës mbledhjeje do të vendosen nga zyrtarët përkatës të institucioneve përgjegjëse (siç parasheh Rregullorja nr. 13/2016 dhe ky udhëzues), të cilët gjithashtu do të ftojnë mbledhjet konsultuese me kohë.

Në përputhje me Rregulloren nr. 13/2016 dhe Udhëzuesin, përgjegjësitë institucionale janë të ndara si në vijim: nënkomitetet - Ministria e Integritimit Evropian; Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike - Ministria e Administratës Publike; dhe Grupi i Veçantë për Normalizim - Zyra e Kryeministrit.

Mbledhjet e OSA - datat	Mbledhjet konsultuese - datat tentative
Komiteti III i Stabilizim-Asociimit (SA), 8 tetor 2019	Mbledhja 1, java 30 shtator - 4 tetor 2019 Mbledhja 2, java 18 - 22 nëntor 2019
Nënkomiteti III i SA për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime, 18 qershor 2019	Mbledhja 1, java 10 - 14 qershor 2019 Mbledhja 2, java 5 - 9 gusht 2019
Nënkomiteti III i SA për Bujqësi dhe Peshkatori, 16 maj 2019	Mbledhja 1, java 6 - 10 maj 2019 Mbledhja 2, java 1 - 5 korrik 2019
Nënkomiteti III i SA për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, 6 mars 2019	Mbledhja 1, java 25 shkurt - 1 mars 2019 Mbledhja 2, java 22 - 26 prill 2019
Nënkomiteti III i SA për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika, 19 shtator 2019	Mbledhja 1, java 9 - 13 shtator 2019 Mbledhja 2, java 4 - 8 nëntor 2019
Nënkomiteti III i SA për Drejtësi, Liri dhe Siguri, 12 - 13 qershor 2019	Mbledhja 1, java 3 - 7 qershor 2019 Mbledhja 2, java 22 - 26 korrik 2019
Nënkomiteti III i SA për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale, 7 shkurt 2019	Mbledhja 1, java 4 - 8 shkurt 2019 Mbledhja 2, java 18 - 22 mars 2019
Nënkomiteti III i SA për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, 14 mars 2019	Mbledhja 1, java 4 - 8 mars 2019 Mbledhja 2, java 15 - 19 prill 2019
Grupi III i Veçantë i SA për Reformën e Administratës Publike	Mbledhja 1, java 6 - 10 maj 2019 Mbledhja 2, java 8 - 12 korrik 2019
Grupi III i Veçantë i SA për Normalizim, 2019 (do të vendoset)	Mbledhja 1, 2019 (data do të vendoset) Mbledhja 2, 2019 (data do të vendoset)